

VENDIM
Nr.435, datë 2.6.2010

**PËR ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE QË KRIJOHEN NGA SHITJA E
DOKUMENTACIONIT TATIMOR, PULLAVE FISKALE DHE BILETAVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 52 të ligjit nr.9920, datë 15.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “c” të nenit 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Të gjitha të ardhurat e realizuara nga shitja e dokumentacionit tatimor, pullave fiskale dhe biletave të transportit rrugor të përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për përballimin e shpenzimeve të prodhimit dhe shpërndarjes së tyre, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Ministrisë të Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha